

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 327, Datë 18.12.2025

MBI

**IMPLEMENTIMIN E INTERVALIT KOHOR 15 MINUTA NË OPERIMIN E
PROCESEVE NË TREGUN E BALANCIMIT**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2559/14 prot., datë 16.12.2025, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit”,

Konstatoi se:

I. Vendimmarrja rregulatore në fuqi dhe intervali aktual i proceseve

- ERE me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020, miratoi Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. Nga miratimi i këtyre rregullave deri më 1 Prill 2021, u realizua periudha e ushtrimit “Dry Run” për aplikimin e rregullave në tregun e balancimit, gjatë së cilës u përdor rezolucioni 1-orësh.
- ERE me vendimin nr. 51, datë 02.04.2024, pranoi pjesërisht kërkesën e OST sh.a., duke përcaktuar që proceset, përfshirë nominimet dhe llogaritjet e disbalancave, të kryhen në intervale njëorëshe deri më 1 korrik 2024.
- Në vijim me vendimet nr. 45, datë 27.02.2025, dhe nr. 117, datë 03.06.2025 u vendos zgjatja e efekteve juridike të këtyre vendimmarrjeve deri më datë 31.12.2025.
- Me zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të ERE-s nr. 45, datë 27.02.2025, deri më 31.12.2025, proceset ku përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave kanë vijuar të kryhen me interval kohor 1 (një) orë.

II. Njoftimet dhe kërkesat e ERE-s për raportime periodike

- ERE me shkresën nr. 1203/4 prot., datë 05.06.2025, njoftoi “KESH” sh.a., “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., “AYEN AS ENERGJI” sh.a., shoqatën “AAES”, “FTL” sh.a., shoqatën e “Prodhuesve të Energjisë deri në 2MW”, shoqatën “AREA”, Operatorin e bursës “ALPEX” sh.a., si dhe “OST” sh.a., mbi vendimin nr. 117/2025.
- ERE me shkresat nr. 1203/5 prot., datë 09.07.2025 dhe nr. 1203/6 prot., datë 09.07.2025, i kërkoj përkatësisht “KESH” sh.a. dhe “FTL” sh.a. (për dijeni “OST” sh.a.) raportime periodike, çdo fillim muaji, mbi ecurinë e implementimit të intervalit 15-minutësh, si dhe mbi aftësinë teknike për ofrimin e këtij shërbimi.
- Duke qenë se nga ana e “KESH” sh.a. nuk ka pasur angazhim mbi raportimin periodik mujor si dhe nga ana e “FTL” sh.a. nuk ka pasur vijueshmëri informimi përsa lënë detyrë në shkresat

e sipërcituara, ERE me shkresën nr. 1203/8 prot., datë 15.09.2025, iu ka risjellë në vëmendje detyrimin që buron nga këto shkresa dhe zbatimin e kushteve të vendimit nr. 117/2025.

III. Qëndrimi i “FTL” sh.a.

- FTL sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1203/7, datë 31.07.2025, ka informuar se është aktive në të gjitha proceset e testimeve dry-run të organizuara nga “OST” sh.a., duke përfshirë realizimin e programimit dhe nominimit të programeve në intervale kohore 15-minutëshe.
- FTL sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2580 prot., datë 06.10.2025, ka depozituar informacion se në cilësinë e liderit të Grupit të Balancimit ka vijuar të marrë pjesë në testimet dry-run duke kryer programimin dhe nominimin e programeve në intervale 15-minutëshe, si dhe ka informuar se është vënë në dispozicion “Sistemi për menaxhimin e Programeve të Planifikimit të Prodhimit”, i cili mundëson nominimin/deklarimin e programeve në interval 15-minutësh; ndërkohë është bërë me dije shqetësimi i prodhuesve me përparësi lidhur me vështirësinë e planifikimit dhe rritjen e kostove të disbalancave.

IV. Qëndrimi i “KESH” sh.a.

- KESH sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2559 prot., datë 02.10.2025, ka bërë me dije se ka nisur procedurat e prokurimit për kryerjen e shërbimit për “upgrade” të sistemeve SCADA në HEC-et në pronësi të saj, me qëllim implementimin automatik të skedulit 15 minuta, duke parashikuar që sistemi të jetë gati në 3-mujorin e dytë të vitit 2026.
- Në vijim, me shkresën nr. 2559/1 prot., datë 16.10.2025, ERE i kërkoi “KESH” sh.a. të depozitojë regjistrin e parashikimeve të prokurimeve ku të specifikohet objekti, specifikimet teknike dhe afati kohor i zhvillimit.
- KESH sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2559/2, datë 30.10.2025, ka depozituar imazhe/foto nga faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimeve Publike, ku janë paraqitur të dhënat përkatëse mbi objektin, specifikimet teknike dhe afatet e procedurave, për investime në njësitë gjeneruese të Kaskadës së Drinit (HEC Koman, HEC Vau i Dejës) me qëllim ndjekjen e sinjalit me rezolucion 15 minuta ndërmjet dy SCADA-ve.

V. Raportimet mujore dhe testimet nga “OST” sh.a.

- Në zbatim të pikës 2 të vendimit nr. 117/2025, “OST” sh.a. ka bërë raportimet mujore mbi testimet për implementimin e intervalit kohor 15 minutësh, sipas shkresave të protokolluara në ERE: nr. 1880, datë 16.06.2025; nr. 2164, datë 25.07.2025; nr. 2359, datë 26.08.2025; nr. 2544, datë 30.09.2025; nr. 2751, datë 31.10.2025; si dhe e-maili i datës 02.12.2025.
- “OST” sh.a., me anë të e-mailit të datës 01.10.2025, ka depozituar informacion të përditësuar se Komiteti Drejtues i Tregut të Përbashkët Evropian ka njoftuar implementimin me sukses të intervalit kohor 15 minuta (15-Minuta MTU) në SDAC, me datë fillimi 30 Shtator 2025 për ditën e lëvrimit më 1 Tetor 2025, si dhe zgjerimin e implementimit të MTU 15-minutëshe në SIDC.

VI. Seanca dëgjimore dhe qëndrimet e palëve

- ERE me shkresën nr. 2559/4 prot., datë 20.11.2025, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 04.12.2025. OST” sh.a., me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2559/5 prot., datë 21.11.2025, kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore. Ndërsa me e-mailin e datës 22.11.2025 të protokolluar me nr. 2559/6, datë 25.11.2025, ERE njoftoi shtyrjen e seancës dëgjimore për zhvillim në datën 09.12.2025.
- Në seancën dëgjimore të zhvilluar më 09.12.2025 morën pjesë përfaqësuesit e “OST” sh.a., “FTL” sh.a., “KESH” sh.a., “ALPEX” sh.a. dhe shoqatat “AAES” dhe “AREA”.

VII. Qëndrimet e palëve dhe afati i kalimit në rezolucion 15-minutësh

- ALPEX sh.a., gjatë seancës dëgjimore, u shpreh se është në fazën e përzgjedhjes së provider-it dhe parashikon kalimin në rezolucion 15 minutësh në zonën e operimit të Shqipërisë në datën 01.07.2026, si dhe fillimin e testimeve përkatëse deri në atë moment.
- Gjatë seancës dëgjimore, disa palë konfirmuan gatishmëri teknike për kalimin në intervalin kohor 15-minutësh, konkretisht “OST” sh.a. dhe “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., ndërkohë që palë të tjera, përfshirë “KESH” sh.a., “FTL” sh.a., shoqatën “AAES” dhe shoqatën “AREA”, kërkuar shtyrjen e afatit të implementimit. Këto subjekte theksuan se implementimi i intervalit kohor 15-minutësh vetëm në tregun e balancimit, pa harmonizim paralel me tregun në avancë dhe pa gatishmërinë teknike të ofruesve kryesorë të shërbimeve të balancimit, krijon mosrakordancë të intervaleve kohore, disbalanca artificiale, vështirësi në planifikimin korrekt të programeve, si dhe impakt financiar negativ për portofolin e pjesëmarrësve të tregut, veçanërisht për grupet e balancimit dhe prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.
- Në këtë kuadër vlerësohet se, në kushtet kur “KESH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. kanë bërë me dije afate konkrete për përgatitjet teknike përkatëse gjatë vitit 2026, zgjatja e efekteve juridike të pikës 1 të vendimit nr. 117, datë 03.06.2025, krijon hapësirën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve teknike dhe realizimin e kalimit të sinkronizuar në rezolucion 15-minutësh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Zgjatjen e efekteve juridike të pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 117, datë 03.06.2025 deri më 30.06.2026.
2. OST sh.a. të bashkëveprojë me “ALPEX” sh.a., e “KESH” sh.a si dhe të vijojë komunikimin me të gjithë pjesëtarët e tregut lidhur me gatishmërinë e tyre për implementimin e intervalit kohor 15 minutësh.
3. OST sh.a. të raportojë çdo muaj në ERE dhe të vijojë me testimet përkatëse për implementimin e intervalit kohor 15 minutësh.
4. “KESH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. të raportojnë çdo dy (2) muaj në ERE, përkatësisht lidhur me zbatimin e projektit që mundëson implementimin e intervalit kohor 15 minutësh në tregun e balancimit dhe mbi ecurinë e përzgjedhjes së ofruesit të shërbimit përkatës.
5. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI